



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 58, Datë 24.02.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NATYRE ENERGY”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.02.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 567/3 prot., datë 23.02.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NATYRE ENERGY” sh.p.k/ në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 24, datë 09.02.2023, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NATYRE ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të vendimmarrjes për mos fillimin e procedurës, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 567/2 prot., datë 15.02.2023 ka përcjellë dokumentacion plotësues brenda afateve që përcakton neni 10, pika 7 i “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar. Ndërkohë ERE me shkresën nr. 567/3 prot., datë 22.02.2023, njoftoi shoqërinë se dokumentacioni i përcjellë prej saj do të shqyrtohej për t’u vlerësuar në vendimmarrjen e radhës.
- Në vijim të protokollimit të Relacionit nr. 567/3 prot., datë 23.02.2023, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NATYRE ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e

furnizimit të energjisë elektrike”, në ERE mbërriti shkresa nr. 567/4 prot., datë 23.02.2023 “Plotësim dokumentacioni”, nëpërmjet së cilës shoqëria ka përcjellë dokumentacion financiar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “NATYRE ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c”; për pikën 2.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
- Nga ky aplikim rezulton se është plotësuar pjesërisht dokumentacioni në vijim:

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të paraqesi në ERE vendimin e Asamblesë së Ortakëve të saj në lidhje me vlerën financiare që do të vejë në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, llogaritur kjo sipas sasive që ka parashikuar të furnizojë, të shoqëruar me vërtetim të gjendjes së llogarisë për disponueshmërinë e shumës që nevojitet për garantimin e të paktën një muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi.
- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NATYRE ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petril AHMETI